



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d), të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 20 paragrafi 1 të Ligjit nr. 04/L-032, për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, nenit 5, shkronja d) dhe nenit 6 e Ligjit nr. 03/L-068 për arsim në komunat e Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 151/2020 për detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit dhe zëvendës drejtorit të institucionit publik edukativo-arsimor dhe aftësues parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedurat e zgjedhjes dhe emërimit, përfundimit të kontratës dhe emërimit të përkohshëm, të nenit 34.1, shkronja d), të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 28.12.2022, mori këtë

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01-151/01-151637/22, E
DT.30.06.2022 PËR CAKTIMIN E KOMISIONEVE PËR REKRUTIM TË
DREJTORËVE DHE ZËVENDËSDREJTORËVE TË INSTITUCIONEVE
EDUKATIVO-ARSIMORE DHE AFTËSUESE NË KRYEQYTETIN E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

- I. Miratohet vendimi për plotësim ndryshimin e vendimit 01-151/01-151637/22, e dt.30.06.2022 për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në kryeqytetin e Republikës së Kosovës.
- II. Sipas pikës I të këtij Vendimi plotësim ndryshim nënkupton:
 1. Ndryshohet neni II, pika I e të gjitha komisioneve e Vendimit 01-151/01-151637/22, e dt.30.06.2022, Arbene Aliu zëvendësohet me Fitnete Tutuli, ndërsa pikat tjera të vendimit mbetën të pa ndryshuara.
- III. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-151/01-277198/22, më 29.12.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

